



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), shpall këtë:

KONKURS

Titulli i vendit të punës: **Përkthyes shqip-anglisht-shqip, (2 pozita),**

Kategoria dhe grada e vendit të punës: **Nivel profesional, koeficienti 6.5, Nr.**

i ref : **AKSP-5/2012,**

Raporton të: **Udhëheqësi i Divizionit të Përkrahjes Gjuhësore,**

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore

1. Përkthim profesional i materialeve nga gjuha Shqipe në gjuhën Angleze dhe anasjelltas, me shkrim dhe simulant, varësisht nga kërkesat e AKSP-se,
2. Në aspektin gjuhësorë të bëjë sigurimin e interpretimit gjatë takimeve, konferencave, seminareve, në takimet me tryezë të rrumbullakët, etj, dhe të përgatisë raportet për ngjarjet që kërkohen,
3. Regjistron dhe arkivon materialet e përkthyer në librat e regjistrit dhe programin elektronik,
4. Bashkëpunon me zyrtarët për përmbushjen e suksesshme të detyrave e gjithnjë në konsultim me zyrtarin e lartë të përkthimit dhe udhëheqësin e Divizionit,
5. Gatishmëria që në çdo kohë të ofrojë ndihmë në çështje të përkthimeve brenda dhe jashtë AKSP-se,
6. Aplikon terminologjinë e unifikuar të gjuhës përkatëse,
7. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm e që kërkohen kohë pas kohe nga Udhëheqësi i Divizionit të Përkrahjes Gjuhësore.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim

Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohet për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit

Për pozitën e Përkthyesit shqip-anglisht-shqip, procedura e konkurrimit është publike (për gjithë të interesuarit).

Shkollimi i kërkuar

- Shkolla e mesme (e obligueshme),
- Diplomë Universitare gjuhë dhe letërsi angleze (përparësi),

Aftësia, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen

Njohuri të mira të punës me kompjuter, me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point), fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe brenda afateve të kufizuara kohore, aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin, vet-iniciativë dhe përkushtim i vëmendjes ndaj detaleve dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor. Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare (e obliguar), njohja e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar (e obliguar), së paku një (1) vit përvojë pune në fushën përkatëse (e nevojshme).

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin

Përzgjedhja e Përkthyesit shqip-anglisht-shqip, bëhet në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregulloren Nr.07/2010 për Emërimin e Nëpunësve Civil.

Kohëzgjatja e emërimit

Për pozitën e Përkthyesit shqip-anglisht-shqip, emërimi është me kohë të pacaktuar (karrierës), periudha provuese 12 muaj.

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 03.05.2012 deri me datën 17.05.2012.

Paraqitja e kërkesave

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), Zyra e Personelit, dhoma nr.1. kati I, ndërtesa e re administrative Vushtrri, ose nëpërmjet adresës elektronike: [E-mail: hazbije.cakiqi@rks-gov.net](mailto:hazbije.cakiqi@rks-gov.net) Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurren.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

Për informata me te hollësishme mund te kontaktoni Zyrën e Personelit nr. tel: 028 570 008 Ext 114 ose 233, prej orës 08:00 - 1600.